

VENDIM
Nr. 469, datë 29.6.2011

**PËR PROCEDURËN PËR DHËNIEN E LICENCAVE TË IMPORTIT, EKSPORTIT DHE
PRODHIMIT TË LËNDËVE PLASËSE PËR PËRDORIM CIVIL**

(Ndryshuar me vendimin nr. 892, datë 4.11.2015)

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 nenit 9 të ligjit nr. 9126, datë 29.7.2003 “Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licenca e importit, eksportit dhe e prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, jepet nga Ministria e Mbrojtjes.
2. Licenca e importit dhe eksportit të lëndëve plasëse për përdorim civil jepet brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, me shkrim, të shoqëruar me dokumentacionin e plotë, ndërsa licenca e prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil jepet brenda 6 muajve nga data e paraqitjes së kërkesës, me shkrim, të shoqëruar me dokumentacionin e plotë.
3. Afati i licencës për importin dhe eksportin e lëndëve plasëse për përdorim civil është 1-vjeçar, ndërsa afati i licencës për prodhimin e lëndëve plasëse për përdorim civil është 8-vjeçar, me të drejtë rinovimi.
4. Për dhënien e licencës së importit, të eksportit dhe të prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil në Ministrinë e Mbrojtjes, krijohet komisioni i dhënies së licencave, përbërja dhe funksionimi i të cilit përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Ministri i Mbrojtjes.
5. Subjekti tregtar, që kërkon të pajiset me licencë importi të lëndëve plasëse për përdorim civil, duhet të ketë këto dokumente:
 - a) Ekstraktin e plotë historik nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;
 - b) Vërtetim nga Prokuroria që nuk është në procedim penal;
 - c) Dokumentacionin e origjinës së mallit me llojet dhe sasinë e lëndëve plasëse nga fabrika prodhuese;
 - ç) Dokumentacionin me të dhënat teknike të përbërjes së lëndëve plasëse, të shoqëruara me fotografi;
 - d) Dokumentacionin për përmbushjen e procedurave për vlerësimin e konformitetit të lëndëve plasëse duke paraqitur një nga modulet e mëposhtme:
 - i. *ekzaminimin e tipit EC (moduli B) dhe sipas zgjedhjes së prodhuesit, njërën prej procedurave të mëposhtme:*
 - konformitetin ndaj tipit (moduli C)
 - sigurimin e cilësisë së produktit (moduli E)
 - verifikimin e produktit (moduli F)
 - ii. *vlerësimin e produktit (moduli G);*
 - iii. *deklaratën e konformitetit lëshuar nga prodhuesi¹.*
 - dh) Lejen për sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit;
 - e) Kontratën e shërbimit për ruajtjen fizike dhe transportimin me të tretë, kur nuk ka licencë për këto shërbime, për transportin e mallrave nga pika doganore hyrëse deri në depot e magazinimit;
 - ë) Autorizimin për magazinimin e lëndëve plasëse, ku të jetë përcaktuar specifikisht kapaciteti mbajtës për lëndët plasëse, kapsolla dhe fitila;
 - f) Autorizimin për transferimin e lëndëve plasëse;
 - g) Lejen për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi;
 - gj) Kopjen e licencës së mëparshme të importit (nëse ka), faturat dhe listën e lëndëve plasëse që ka përdorur më parë, deklaratën për lëndët plasëse gjendje në depo dhe cilësinë e këtyre lëndëve;

¹ Ndryshuar me pikën 1/a, të vendimit nr. 892, datë 4.11.2015

h) Mandatpagesën e tarifës përkatëse.

i) *prononcimin me shkrim nga ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë mbi besueshmërinë e subjektit për të kryer veprimtari me lëndët plasëse*².

6. Subjekti tregtar i pajisur me licencë importi, duhet që:

a) Për çdo parti malli, të njoftojë, *7 ditë*³ përpara mbërritjes së mallit në Shqipëri, me anën e një vetëdeklarimi, komisionin e dhënies së licencave, në Ministrinë e Mbrojtjes, për sasinë që do të importojë dhe gjendjen në magazinë;

b) Të dërgojë pranë komisionit të dhënies së licencave, në Ministrinë e Mbrojtjes, dokumentet e importit brenda 15 ditëve nga data e importimit, të shoqëruara me deklaratat doganore;

c) Të dërgojë pranë komisionit të dhënies së licencave në Ministrinë e Mbrojtjes, dokumentet vjetore të harxhimit ose të shitjes, brenda datës 15 dhjetor të çdo viti;

ç) Të mbajë regjistra të rregullt për shitjen e lëndëve plasëse, ku të jenë përcaktuar:

i) emri i subjektit të cilit i janë shitur lëndët plasëse;

ii) numri i autorizimit për përdorim civil të lëndëve plasëse, lëshuar nga *Ministria përgjegjëse për veprimtarinë minerare*⁴;

iii) sasia e shitur ose e përdorur.

7. Subjekti tregtar, që kërkon të pajiset me licencë eksporti të lëndëve plasëse, duhet të ketë këto dokumente:

a) Ekstraktin e plotë historik nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;

b) Vërtetim nga Prokuroria që nuk është në procedim penal;

c) Kopjen e kontratës së lidhur me subjektin përkatës, të shoqëruar me emërtimet, peshën bruto dhe neto;

ç) Listën sipas emërtimeve, me të dhënat teknike, të shoqëruara me fotografi, etiketat e përdorimit, të vendosura nga fabrika prodhuese;

d) *Dokumentacionin për përmbushjen e procedurave për vlerësimin e konformitetit të lëndëve plasëse duke paraqitur një nga modulet e mëposhtme:*

i. *ekzaminimin e tipit EC (moduli B) dhe sipas zgjedhjes së prodhuesit, njërën prej procedurave të mëposhtme:*

– *konformitetin ndaj tipit (moduli C)*

– *sigurimin e cilësisë së produktit (moduli E)*

– *verifikimin e produktit (moduli F)*

ii. *vlerësimin e produktit (moduli G),*

iii. *deklaratën e konformitetit lëshuar nga prodhuesi*⁵.

dh) Dokumentacion në të cilin përcaktohet origjina e mallit;

e) Autorizimin për transferimin e lëndëve plasëse;

ë) Kontratën e shërbimit për ruajtjen fizike dhe transportimin me të tretë, kur nuk ka licencë për këto shërbime, për transportin e mallrave nga depot e magazinimit deri në pikën doganore dalëse;

f) Deklaratën ose certifikatën nga përdoruesi i fundit (END-USER);

g) Kopje të licencës së importit dhe të lejeve të tranzitit, nëse ka;

gj) Mandatpagesën e tarifës përkatëse;

h) *prononcimin me shkrim nga ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë mbi besueshmërinë e subjektit për të kryer veprimtari me lëndët plasëse*⁶.

8. Subjekti tregtar i pajisur me licencë importi, duhet që:

a) Për çdo parti malli, të njoftojë, *7 ditë*⁷ më parë, me anën e një vetëdeklarimi, komisionin e dhënies së licencave, në Ministrinë e Mbrojtjes, për sasinë që do të eksportoje dhe gjendjen në magazinë;

² Shtuar me pikën 1/b, të vendimit nr. 892, datë 4.11.2015

³ Ndryshuar me pikën 4, të vendimit nr. 892, datë 4.11.2015

⁴ Ndryshuar me pikën 2, të vendimit nr. 892, datë 4.11.2015

⁵ Ndryshuar me pikën 3/a, të vendimit nr. 892, datë 4.11.2015

⁶ Shtuar me pikën 3/b, të vendimit nr. 892, datë 4.11.2015

⁷ Ndryshuar me pikën 4, të vendimit nr. 892, datë 4.11.2015

b) Të dërgojë pranë komisionit të dhënies së licencave, në Ministrinë e Mbrojtjes, brenda 15 ditëve nga data e eksportimit, dokumentet e eksportit të shoqëruara me deklaratat doganore, si dhe dokumentet vjetore të harxhimit ose të shitjes, brenda datës 15 dhjetor të çdo viti.

9. Subjekti i interesuar, që kërkon të pajiset me licencë për prodhimin e lëndës plasëse për përdorim civil, paraqet në Komisionin e Dhënies së Licencave kërkesën me shkrim, në formë autobiografike, me adresën e saktë dhe dokumentet origjinale ose fotokopjet e noterizuara si më poshtë:

- a. ekstraktin e plotë historik nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;
- b. vërtetimin nga prokuroria, që shoqëria nuk është në procedim penal;
- c. lejen për sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit, të tipit "C", për ambientet e prodhimit dhe magazinimit;
- ç. lejen e ndërtimit, shoqëruar me projektin e ndërtimit për prodhimin e lëndëve plasëse;
- d. projektin teknologjik të prodhimit, të miratuar nga një inxhinier projektues i licencuar dhe me eksperiencë në projektimin e linjave teknologjike ose nga një institucion projektimi vendas ose i huaj;
- dh. aktin teknik si dhe projektin për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, për mjediset ku do të magazinohet dhe prodhohet lënda plasëse, ku të jenë përcaktuar sistemet e shuarjes nga zjarri si brenda edhe jashtë ambienteve të prodhimit dhe magazinimit;
- e. kontratën e punësimit me Drejtuesin Teknik, i cili duhet të jetë inxhinier mekanik, kimist ose specialist prodhimi me përvojë 2 vite pune, në fushën e prodhimit të lëndëve plasëse;
- ë. planin e veprimit si dhe dokumentacionin për kushtet e sigurisë në punë, trajnimin e punonjësve dhe stafit, të miratuar nga Drejtuesi Teknik, i cili është personi që ka përgjegjësinë ligjore për zbatimin dhe respektimin e rregullores së sigurimit teknik të procesit të prodhimit dhe magazinimit, si dhe për trajnimin e punonjësve për masat e sigurisë në punë, sigurinë e prodhimit dhe sigurinë e magazinimit;
- f. kontratën për ruajtjen e ambienteve të prodhimit dhe magazinimit, me një shoqëri të pajisur me licencë të ruajtjes së sigurisë fizike, ku të jetë parashikuar një plan i detajuar i masave të sigurisë;
- g. autorizimin për magazinimin e lëndëve plasëse, lëshuar nga ministria kompetente për rendin dhe sigurinë;
- gj. mandat pagesën e tarifës;
- h. prononcimin me shkrim nga ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë mbi besueshmërinë e subjektit për të kryer veprimtari me lëndët plasëse.

Subjekti i interesuar, që kërkon të pajiset me licencë për prodhimin e lëndës plasëse për përdorim civil, për produktet të cilat kërkon të prodhojë, duhet të kryejë, pranë një laboratorit të akredituar, procedurat e vlerësimit të konformitetit të artikujve "lëndë plasëse" duke ndjekur njërin nga procedurat e mëposhtme:

- a. ekzaminimin e tipit EC (moduli B) dhe sipas zgjedhjes së prodhuesit njërin prej procedurave të mëposhtme:
 - i. konformitetin ndaj tipit (moduli C);
 - ii. sigurimin e cilësisë së produktit (moduli E);
 - iii. verifikimin e produktit (moduli F);
- b. vlerësimin e produktit (moduli G).

Për çdo ndryshim që mund të bëjë subjekti gjatë aplikimit apo pas marrjes së licencës, në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim, duhet të njoftojë, brenda 10 ditësh pune, Komisionin e Dhënies së Licencave.

Subjekti i pajisur me licencë prodhimi lëndësh plasëse për përdorim civil, për dokumentacionin e përcaktuar në këtë nen, i cili lëshohet me afat të caktuar vlefshmërie, ka detyrimin e rinovimit të tij dhe paraqitjen para Komisionit të Dhënies së Licencave, brenda 5 ditësh pune, nga data e mbarimit të afatit të vlefshmërisë⁸.

9.1 Pas plotësimit të kriterëve të përgjithshme të licencimit, sipas pikës 9, të këtij vendimi, Komisioni i Dhënies së Licencave, për nevoja të kryerjes së procedurave të vlerësimit të konformitetit, merr vendim për të lejuar subjektin për të prodhuar lëndë plasëse për përdorim civil, vetëm për nevoja testimi, deri në pajisjen me njërin nga çertifikatat e konformitetit të mësipërme, nga një laborator i akredituar⁹.

⁸ Ndryshuar me pikën 5, të vendimit nr. 892, datë 4.11.2015

⁹ Shtuar me pikën 6, të vendimit nr. 892, datë 4.11.2015

10. Subjekti tregtar i pajisur me licencë prodhimi duhet që, çdo fund muaji, të raportojë për sasinë e mallrave të prodhuara, pranë komisionit të dhënies së licencave, në Ministrinë e Mbrojtjes dhe, brenda datës 15 dhjetor të çdo viti, të raportojë për sasinë e mallit të prodhuar, shitjet, harxhimet, eksportet, të shoqëruara me fatura.

11. Komisioni i dhënies së licencave në Ministrinë e Mbrojtjes për qëllimet e përcaktuara në këtë vendim, ka të drejtë të kryejë kontrolle dhe verifikime rast pas rasti, në pikat doganore për importin e lëndëve plasëse, në depot e magazinimit dhe në linjat e prodhimit.

12. Komisioni i dhënies së licencave në Ministrinë e Mbrojtjes, vendos marrjen e masave administrative më gjobë, me pezullim dhe me heqje të licencës në rastet kur:

a) Gjatë verifikimeve dhe kontrolleve të ushtruara, nëse vëren shkelje të kriterëve apo të kushteve të përcaktuara në këtë vendim, merr masa administrative me gjobë nga 20 000 (njëzet mijë) deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë, sipas rëndësisë së shkeljeve;

b) Gjatë verifikimeve dhe kontrolleve të ushtruara, nëse vëren se, pas pajisjes me licencë, subjekti humbet ose ndryshon kushtet dhe kriteret e përcaktuara për dhënien e licencës, përveç masave administrative të parashikuara në shkronjën "a", vendos pezullimin e licencës;

c) Licenca hiqet në rastet kur:

- Gjatë verifikimeve dhe kontrolleve të ushtruara, vëren përsëritjen e pajustificuar të shkeljeve, të përcaktuara në shkronjën "a";

- Subjekti tregtar kryen vepër penale, që lidhet me ushtrimin e veprimtarisë së importimit, eksportimit dhe prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil apo që cenon jetën e shëndetin e njeriut;

- Subjekti tregtar, gjatë importimit, eksportimit apo prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil, shkel rregullat teknike të prodhimit, transportimit, përdorimit dhe të konformitetit të lëndëve plasëse, duke rrezikuar jetën e njerëzve, të kafshëve dhe mjedisin.

13. Personat e interesuar mund të ankohen kundër vendimeve të komisionit të dhënies së licencave te Ministri i Mbrojtjes, në përputhje me ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

14. Tarifat financiare për dhënien e licencave të importimit, eksportimit dhe prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil, caktohen me urdhër të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Mbrojtjes.

15. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

16. Vendimi nr. 597, datë 10.9.2004 i Këshillit të Ministrave "Për procedurën për dhënien e lejes së importimit, eksportimit dhe prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha